

# *Mësuesi më i madh i të gjitha kohërave*

*(Mt. 5:1–3; 7:28, 29)*

Perëndia kishte vetëm një Bir dhe Ai ishte mësues. Perëndia do që secili prej nesh të ecë në hapat e Jezusit (Mt. 28:19, 20; Heb. 5:12). Nëse kemi dëshirë për të mësuar të tjerët, atëherë do të ishte mirë të uleshim në këmbët e Mësuesit më të madh të të gjithë kohërave. Së paku katër karakteristika e bëjnë Jezusin të tillë.

## I. MISIONI I TIJ

A. Jezusi e dinte se cili ishte misioni i Tij: të shpëtonte shpirtrat e njerëzve (Lk. 19:10). Pjesë e rëndësishme e këtij misioni ishin mësimet e Tij. Si mësues, ne duhet ta kuptojmë se misioni ynë nuk është të gjejmë mënyra se si të vrasim kohën apo si të zbavitemi. Qëllimi kryesor i jetës sonë si kristianë është të ndihmojmë shpëtimin e shpirtrave të humbur duke i mësuar ata se si mund të vijnë te Jezusi.

B. Jezusi besonte në misionin e Tij.

1. Ai u përgatit për të. A jemi ne duke u përgatitur siç duhet për të përhapur Fjalën e Perëndisë?
2. Ai ishte i gatshëm të bënte të gjitha përpjekjet. A jemi gati të bëjmë sakrificat e duhura për të mësuar të tjerët?
3. Ai nuk dekurajohej menjëherë. Ai s'ndaloi së përpjekuri. A besojmë në çfarë bëjmë, apo dorëzohemi dhe heqim dorë lehtësisht?

## II. MESAZHI I TIJ

A. Mesazhi i Jezusit ishte i fuqishëm, sepse

ishite *Fjala e Perëndisë*. N.q.s duam të shpërndajmë Fjalën, ne duhet të jemi të gatshëm të studiojmë seriozisht Biblën.

B. Në të njëjtën kohë, mesazhi i Jezusit ishte praktik, sepse ndryshoi jetët e dëgjuesve të Tij. Mësimi ynë s'duhet të jetë shumë teorik, por duhet të synojë të ndryshojë jetët e studentëve tanë.

## III. METODAT E TIJ

A. Metodat janë të rëndësishme. Mënyra se si mësojmë është shpesh thelbësore në procesin e të mësuarit.

1. Mësimet e Jezusit përfshijnë çdo aspekt të jetës.

a. Ai përdori shumë metoda:

- (1) Metodën e shpjegimit
- (2) Metodën me pyetje dhe përgjigje (Jezusi i pyeste dëgjuesit dhe ata do të përgjigjeshin.)
- (3) Metodën e diskutimit (Jezusi do t'i ftonte dëgjuesit e Tij në diskutim dhe do të diskutonte bashkë me ta.)
- (4) Metodën e tregimit (Jezusi do të tregonte shëmbëllyra që do ta bënë më të qartë mësimin e Tij.)
- (5) Projektimi në të ardhmen (Shpesh Jezusi do të projektonte mësimet e Tij në të ardhmen).
- (6) Metodën dramatike

- b. Gjithashtu Ai përdori shumë mjete vizuale për mësim.
- 2. Metodatat e Tij kishin të përbashkët këto dy karakteristika:
  - a. Metodatat kishin një qëllim të vetëm. Ato i ndihmonin dëgjuesit që të kuptonin mesazhin e Jezusit.
  - b. Ato ishin të thjeshta.
- B. A është e mundur që ne ta ndjekim Jezusin në mësimet tona? A na kuptojnë dëgjuesit tanë kur ne flasim apo shpjegojmë?

#### IV. JETA E JEZUSIT

- A. Jezusi *jetoj* atë që predikonte (Veprat 1:1; Lk. 23:4, 41). Ai nuk u kërkonte njerëzve të bënin gjëra që Ai vetë nuk do t'i bënte. Kjo e rriste shumë efektin e

fjalëve dhe të mësimave të tij.

- B. A jetojmë *ne* një jetë të njëjtë me atë që u mësojmë dëgjuesve tanë me anë të predikimit? (Jakobit 3:1; Mt. 23:3).
  1. A shkojmë në çdo shërbesë në kishë?
  2. A kemi një trup dhe një mendje të pastër?
  3. A jemi gati të ndimohemi dhe inkurajojmë të tjerët?
  4. A jemi të përfshirë në jetën e kishës?

#### KONKLuzion

Nuk ka ndonjë punë më të rëndësishme se sa t'u mësosh të tjerëve Fjalën e Perëndisë. Nga ana tjetër kjo është një punë që kërkon shumë përgjegjësi. Perëndia na ndimoftë që ne të gjithë të mund të imitojmë Krye-Mësuesin, kështu që ndonjë ditë mund të ulemi pranë këmbëve të Tij në qiell dhe të dëgjojmë mësimet e Tij.

Autor: *David Roper*  
Marrë nga seria: "*Tako Zotin*"  
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara